



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 154, Datë 03.07.2018

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË
“OBERALDI ENERGJITIK” SH.P.K, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË NGA HECET “KRYEZI 3” ME FUQI TE INSTALUAR
122.2 KW, “KRYEZI 4” ME FUQI TE INSTALUAR 310.7 KW DHE “KRYEZI 5” ME
FUQI TE INSTALUAR 886.5 KW, ME FUQI TOTALE 1320 KW**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “a”, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, neit 5, pika 1 gërma “a” dhe nenit 10 pika 3, të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 109, datë 29.06.2016, dhe nenit 19, pika 1, gërma “a”, të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 03.07.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Oberaldi Energjitik” sh.p.k për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Oberaldi Energjitik” sh.p.k me shkresën e protokolluar në ERE nr. 442 Prot, datë 11.06.2018, ka paraqitur kërkesën për tu pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC – et “Kryezi 3”, me fuqi 122.2 kW, “Kryezi 4”, me fuqi 310.7 kW dhe “Kryezi 5”, me fuqi 886.5 kW.
- Aplikimi i shoqërisë “Oberaldi Energjitik” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike” si më poshtë:

➤ Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “b”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3; 4.1.4; 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 9 pika 2, gërma “d” (vërtetim nga Gjykata);
- Nenin 9, pika 3 gërmat “a” (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave dhe sigurimeve shoqërore) dhe “c” (dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit),
- Nenin 9 pika 4.1.5, gërma “b”, (Leja e përdorimit të ujit), do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të *“Rregulloren për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”*, ti paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Oberald Energjetik” sh.p.k në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hidrocentralet: “Kryezi 3”, me fuqi 122.2 kW, “Kryezi 4”, me fuqi 310.7 kW dhe “Kryezi 5”, me fuqi 886.5 kW, me Fuqi Totale 1320 kW, për një afat 30 vjeçar.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.